



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - Ministarstva za Obrazovanje  
Nauku i Tehnologjiu - Ministry of Education, Science and Technology  
**Inspektoriati i Arsimit në Republikën e Kosovës**

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit-Inspektoriati i Arsimit të Kosovës shpall:

## Konkurs

### Lëvizje brenda kategorisë

*Të drejtë për aplikim në këtë procedure kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.*

|                                   |  |
|-----------------------------------|--|
| <b>Titulli i pozitës së punës</b> | Inspektor i Arsimit  |
| <b>Klasa e pozitës</b>            | Profesional 1  |
| <b>Koeficienti/Paga</b>           | 8  |
| <b>Nr. i kërkuar</b>              | 3  |
| <b>Data e njoftimit</b>           | 16/08/2021   |
| <b>Afati për aplikim</b>          | 01/09/2021 - 15/09/2021  |
| <b>Institucioni</b>               | Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit-Inspektoriati i Arsimit të Kosovës |
| <b>Departamenti</b>               | SIA në Prishtinë   |
| <b>Divizioni</b>                  |  |
| <b>Vendi i punës</b>              | SIA PRISHITINË   |
| <b>Nr. i Referencës</b>           | RN00007085   |
| <b>Kodi</b>                       | RPC0000941   |



## **1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës**

---

1. Harton dhe zhvillon planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të njësishë dhe jep rekomandime lidhur me realizimin e këtyre objektivave;
2. Në bashkëpunim me drejtorin, bënë vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime dhe përmirësime me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së punës;
3. Mbikëqyr dhe monitoron zbatimin e ligjeve dhe të akteve nënligjore që rregullojnë fushën e arsimit në sektorin publik dhe privat si dhe zbatimin e standardeve për sigurimin e cilësisë së arsimit;
4. Harton planin vjetor të inspektimeve pedagogjike të institucioneve edukative arsimore dhe procedura standarde lidhur me inspektimet e arsimit;
5. Inspekton të gjitha institucionet edukative dhe arsimore në sektorin publik dhe privat në aspektin pedagogjik lidhur me zhvillimin e procesit mësimor dhe organizimin, funksionimin e tyre;
6. Shqyrton dhe vendos ankesat në shkallë të parë si dhe iniciacionin e procedurave adekuate administrative në mbrojtje të ligjshmërisë dhe rregullsisë të procesit mësimor dhe veprimtarisë së institucioneve arsimore;
7. Verifikon saktësinë e dokumenteve të lëshuara nga institucionet arsimore publike dhe private si dhe siguron pajtueshmërinë e tyre me legjislacionin në fuqi;
8. Përgatit raporte periodike në bazë të inspektimeve të kryera dhe jep rekomandime për ngritjen e cilësisë në procesin arsimor;
9. Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;
10. Të vlerësojë përparimin dhe cilësinë e zbatimit të kurrikulës, aspektin pedagogjik të mësimdhënies dhe të vlerësimit, realizimin e Planit Individual të Arsimit (PIA) për fëmijët me aftësi të kufizuara;
11. Të vlerësojë materialet dhe mjetet e konkretizimit për mësimdhënie dhe të nxënë dhe përdorimi i tyre i përshtatshëm;
12. Të rekomandojë masa për përmirësim, duke përfshirë trajnimin për mësimdhënës, ndryshimet në qasjet pedagogjike, organizimin e ndryshëm të orëve, orët plotësuesenë lëndë të caktuara;

## **2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta**

---

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit.
- Në rastin e konkurimit për lëvizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.



### 3. Kërkesat e përgjithshme formale

---

1. · Kualifikime të posaçme profesionale;
2. · Diplomë universitare të studimeve themelore dhe postdiplomike 300 kredi/ ECTS, (MA, MSC, MR) në fushën e arsimore dhe juridike;
3. · Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dhjetë 10 vite përvojë pune në fushën arsimore dhe juridike;
4. · Të mos këtë ushtruar funksione politike në tre (3) vitet e fundit.
5. · Të mos jetë i dënuar;

### 4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

---

- Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;
- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

### 5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

---

1. · Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
2. · Kopjet e dëshmisë së punësimit
3. · Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
4. · Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
5. · Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende
6. · Dëshmi që nuk është nën hetime.

### 6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

---

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 22/09/2021, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net> )

### 7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë

---

- 21/09/2021, MASHTI, ora 10.30



## 8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

---

- Njohuri dhe përvojë në fushën e edukimit dhe arsimimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të ligjshmërisë;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme lidhur me arsimin
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit).

## 9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

---

- Intervist

## 10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

---

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 11. Mënyra e aplikimit

---

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

## 12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

---

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk prahen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

